

Da: Valon Lluka <valon.lluka@vlora-airport.com>

Data: 1 settembre 2025 alle ore 20:34:15 CEST

A: Emin Pacolli <Emin.Pacolli@mabetex.com>

Cc: Korab Toplica <Korab.Toplica@mabetex.com>

Oggetto: Lidhur me financimin e mundshem nga Delphos

I nderuar Emin,

Në vijim të bisedës së sotme, por edhe të atyre paraprake, në lidhje me angazhimin e Mabco Constructions për financim nga Delphos, ndiej detyrimin të theksoj edhe njëherë se çdo formë financimi që lidhet me Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës duhet të kryhet rreptësisht në përputhje me përcaktimet dhe detyrimet qëi ngarkohen Shoqërisë Koncesionare dhe ortakëve të saj përfshirë Mabco Constructions SA si ortaku mazhoritar sipas Kontratës së Koncesionit dhe marrëveshjeve përkatëse me financuesin kryesor, BKT.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të nënvizohet se barrësimi i Shoqërisë Koncesionare, qoftë mbi kuota apo mbi të hyrat e garantuara – pra çdo veprim që prek të drejtat dhe/ose interesat e saj në funksion të financimit të punimeve – sipas nenit 19.3 të Kontratës së Koncesionit, mund të kryhet vetëm pas miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktues/Qeverisë Shqiptare.

Çdo veprim i ndërmarrë në kundërshtim me këtë detyrim përbën shkelje kontraktuale dhe përbën arsye për zgjidhjen e kontratës së koncesionit për shkak të veprimit të paligjshëm. Nënvizojë se Aeroporti i Vlorës është projekt me interes publik, mbi të cilin Republika e Shqipërisë, përmes Qeverisë, ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe aktive, si rezultat i së ciles ‘pronësi’ ka ruajtur të drejtat e miratimeve paraprake për të siguruar mbrojtjen e interesit të saj të ligjshëm.

Përvec nga sa më lartë, çdo barrësim apo marrje detyrimesh të tjera monetare, përfshirë marrjen e huave në çfarëdo forme, pa miratimin paraprak me shkrim të BKT, përbën shkelje të nenit 16 të Kontratës së Kredisë dhe sjell zgjidhjen e menjëhershme të saj.

Thënë këtë, theksoj se çdo veprim i ndërmarrë në kundërshtim me këto dispozita përbën shkelje të rëndë të Kontratës së Koncesionit dhe rrezikon seriozisht realizimin e projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës.

Si Administrator i VIA-s, që nga themelimi i shoqërisë, kërkoj që çdo vendim apo veprim të ndërmerret në përputhje të plotë me përcaktimet kontraktuale dhe njëkohësisht bëj me dije se refuzoj kategorikisht çdo veprim që cenon këto kufizime dhe dispozita.

Me respekt,

Valon Lluka
Administrator

Vlora International Airport
Donika Kastrioti 4
1000 Tirana, Albania